



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr 1004 Prot
1

Tiranë, më 13/09 2023

N J O F T I M

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015, Rregullores së Brendshme të Institucionit dhe në zbatim të Kalendarit Artistik për periudhën Janar – Dhjetor 2023, miratuar me Vendimin e Bordit Artistik nr.62, datë 20.07.2023, trupa e korit do të realizojë veprën Stabat Matter e G.Rossini, shfaqje e parashikuar për t'u vënë në skenën e TKOBAP në datën 28/10/2023.

Vepra kërkon një kor përtej kapaciteteve aktuale në TKOBAP dhe për të realizuar një shfaqje dinjitoze duke iu afruar më tepër parametrave europianë, sektori i korit, si një komponent shumë i rëndësishëm në këtë shfaqje, duhet të ketë një tingëllim më të plotë prandaj shpallet hapja e audicionit për shtimin e numrit të korit për realizimin e kësaj vepre.

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se **audicioni do të zhvillohet në datën 28/09/2023 ora 14:00** në **Sallën e Korit të Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë**, në katin e katërt brenda ambienteve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor.

Të gjithë ata artistë të jashtëm të interesuar për pjesëmarrje duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP ose në e-mailin sekretaria@tkob.gov.al deri në datën **28/09/2023**, ora **12:00** kërkesën për shprehje interesi për marrjen pjesë në audicion.

Programi artistik:

Vepra Stabat Matter (Parti koral) e G.Rossini

MIRATOI

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA

